



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:293717

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876283

KPPP.nr.2234/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Company Ardhmëria Sh.P.K., me seli në Gjilan, me NUI: 810274738, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Ilir Shaqiri me seli të zyrës në Gjilan, kundër debitorit “Bashkim Meti” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me adresë në fshatin Koliq, me NUI: 811336529, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.776/23 të datës 23.11.2023, të nxjerrë nga Përmbaresi Privat Besnik Nuhiu me seli të zyrës në Gjilan, jashtë seancës me datë 19.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Bashkim Meti” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.776/23 të datës 23.11.2023, të nxjerrë nga Përmbaresi Privat Besnik Nuhiu, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimi të debitorit në shumë të përgjithshme prej 104 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.776/23 të datës 23.11.2023, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës nr.76/22 të datës 08.06.2022, dhe faturës nr.90/22 të datës 30.06.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 5,789.30 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e kalimit të afatit për pagesë, si dhe shpenzimet përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumenti përmbarues nuk është i përshtatshëm për t’u përmbaruar, dhe se dokumenti me të cilin është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kriteret nga dispozitat e nenit 29 të LPP-së. Më tej ka theksuar se kontestues është fakti se fatura për të cilën pretendon kreditori nuk është pranuar asnjëherë, dhe i njëjti pa e pranuar asnjëherë faturën në fjalë ka kryer pagesa në emër të saj derisa siç shihet nga ato fatura të cilat i ka pranuar dhe i ka nënshkruar vet debitori janë paguar në tërësi. Ka shtuar se është e papranueshme se si organi përmbarues i është referuar faturave të kreditorit pa e specifikuar saktë se cila prej faturave janë paguar dhe cila faturë përmban obligimin kryesor për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa të refuzohet si i pabazuar në tërësi urdhri për përmbarim, të anulohen veprimet e ndërmara deri më tani, si dhe të obligohet kreditori që në emër të shpenzimeve të përfaqësimit të paguajë shumën prej 312.00 Euro dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori, në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, me arsyetimin se faturat lëndore kreditori ia ka dorëzuar debitorit për të paguar shumat përkatëse të borxhit në afatin partiv, mirëpo të njëjtin borxh nuk e ka paguar ashtu siç ka qenë në faturat në fjalë, duke i mbetur borxh kreditorit për të dy faturat në shumën prej 5,789.30 Euro. Ka shtuar se fatura si dokument i besueshëm i përmban të gjitha tiparet ligjore të përmbarueshmërisë, ndërsa i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, si dhe i ka kërkuar shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 156 Euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.76/22 të datës 08.06.2022, në shumën prej 13,969.30 Euro, nga e cila shumë debitori ka paguar shumën prej 13,250.00 Euro ndërsa ka mbetur borxh shumë prej 719.30 Euro, si dhe faturën nr.90/22 të datës 30.06.2022, në shumën prej 12,570.00 Euro nga e cila shumë debitori ka paguar shumën prej 7,500.00 Euro ndërsa ka mbetur borxh shumë prej 5,070.00 Euro, fakte këto që vërtetohen nga propozimi për përmbartim i kreditorit si dhe nga dëshmitë e pagesave të bashkëngjitura në shkresat e lëndës.

Gjykata konstaton se fatura nr.76/22 e datës 08.06.2022 i përmban të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37 dhe atë të dhënat për kreditorin dhe debitorin, numrin e faturës, datën e faturimit, si dhe objektin, llojin, shumën, dhe nënshkrimin e pranimin nga ana e debitorit, ndërsa fatura nr.90/22 e datës 30.06.2022 i përmban të gjitha elementet përmbajtjesore, mirëpo në këtë faturë mungon nënshkrimi i pranimin të debitorit. Megjithatë, debitori me vet faktin se ka paguar pjesërisht borxhin që rrjedh nga kjo faturë në shumën prej 7,500.00 Euro, për gjykatën kjo nënkupton se debitori e ka pranuar detyrimin që rrjedhë nga kjo faturë, rrjedhimisht e ka pranuar faturën.

Prandaj gjykata vlerëson se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme dhe për zbatimin e përmbartimit, pasi në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për

përmbarrim faturat në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par.1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarrimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2234/23, me datë 19.06.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.